

VENDIM
Nr. 486, datë 30.7.2021

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMEVE (KUZ) NGA UJËSJELLËS-
KANALIZIME SHA, LAGJJA ‘MBROSTAR’, FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve (Kuz) nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., lagjja ‘Mbrostar’, Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronari i pasurisë të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 202 878 (dyqind e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 202 878 (dyqind e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh të përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Fier.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Fier.

8. Bashkia Fier të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA
REALIZIMI I PROJEKTTIT "NDËRTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMEVE (KUZ) NGA UJËSJELLËS
KANALIZIME SHA LAGJIA MBROSTAR, FIER"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloj i pasurisë	Sip. totale /m ²	Sip.e shpronësuar/ m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Urani Prifti	8533	13/66	Truall		18,4	11.026	202,878	Konfirmuar nga ASHK
	Vlera totale				-	18,4		202,878	

Shënime.

1. Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e bartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".